

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНСКЕ СЕ ВЕРИУТ
ЈАВНО ПРЕТПРИЈАТИЕ ЗА ДРЖАВНИ ПАТИШТА
НДЕРМАРРА ПУБЛИКЕ ПЕР РРУГЕ ШТЕТЕРОРЕ
Бр.-Нр. 02 - 12888/9
26 - 12 - 2022 20 год.-viti
СКОПЈЕ - ШКУР

НДЕРМАРРА ПУБЛИКЕ ПЕР РРУГЕ ШТЕТЕРОРЕ

ПРОГРАМИ ВЈЕТОР ПЕР НДЕРТИМ, РИКОНСТРУИМ,
РЕХАБИЛИТИМ, МИРЕМБАЈТЈЕ ДНЕ МБРОЈТЈЕ ТЕ
РРУГЕВЕ ШТЕТЕРОРЕ ПЕР ВИТИН 2023



Shkup,
Dhjetor, 2022

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 9/97, 06/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/19 dhe 89/22) dhe nenit 20 të Statutit të Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore, Bordi Drejtues miratoi Programin vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore për vitin 2023:

HYRJE

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore është themeluar më 03.01.2013 me Vendim për themelim nr. 41-10147/1 të datës 28.12.2012, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 1 nga data 02.01.2013. Ndërmarrja Publike është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër NVAS 6839673 dhe e njëjta është pasardhëse ligjore e Agjencisë për Rrugë Shtetërore Shkup.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore e organizon punën e saj, planifikimin, zhvillimin dhe sigurimin e të hyrave në bazë të Programit vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore.

I.

TË HYRAT E PLANIFIKUARA DHE TË ARDHURAT NGA KREDITE E HUAJA TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE NË VITIN 2023

Të hyrat e planifikuara për vitin 2023 përfshijnë me ligj burimet e parashikuara të financimit për kryerjen e veprimtarisë themelore të ndërmarrjes, të përcaktuara sipas Ligjin për Rrugët Publike, edhe atë:

- 1) pjesë të akcizës nga derivatet e naftës;;
- 2) kompensim për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe automjetet me prizë (taksë rrugore)
- 3) kompensim për shfrytëzimin e rrugës publike, pjesë të saj ose e objektit në rrugë (taksa rrugore);
- 4) kompensim për:
 - a) vendosjen e mbishkrimeve dhe të tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
 - b) lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
 - c) vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe mbrojtëse të rrugës shtetërore,
 - ç) ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve komerciale në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
 - d) shfrytëzimi i tepruar i rrugës,
 - dh) transport i jashtëzakonshëm dhe
 - e) dëmi i shkaktuar në rrugë dhe objektet rrugore;
- 5) mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 6) hua dhe kredite

7) të hyra të tjera

Shuma e mjeteve nga pika 1 përcaktohet me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e njëjta nuk mund të jetë më pak se 20% e të hyrave të përgjithshme në bazë të akcizës nga derivatet e naftës. Mjetet transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në llogarinë e Ndërmarrjes Publike të paktën 4 herë në vit, në interval prej të paktën 3 muajve kalendarik.

- Pasqyrë tabelare e të hyrave të planifikuara dhe të ardhurave nga kreditet e huaja për vitin 2023

TË HYRAT DHE TË ARDHURAT NGA KREDITET E HUAJA	PRGRAMI PËR VITIN 2023
TË HYRAT	11.193.000.000
1. Pjesë e akcizës nga derivatet e naftës	5.000.000.000
2. Taksa rrugore	3.800.000.000
3. Regjistrimi (taksa rrugore)	2.300.000.000
4. Të hyrat tjera nga puna	93.000.000
Bilanci i transferuar nga viti 2022	1.000.000.000
TË ARDHURAT NGA KREDITET E HUAJA	11.508.000.000
1. Kredi nga Banka Botërore	1.081.000.000
2. Kredi nga BERZH	4.427.000.000
3. Kredi nga banka Eksim	6.000.000.000
Mjete nga Buxheti për vitin 2023 - për investime në infrastrukturën rrugore	15.000.000.000
GJITHSEJ	38.701.000.000

I.1 Në vitin 2023 është planifikuar të realizohen të hyra në vlerë të përgjithshme prej 11.193.000.000 denarë, dhe atë:

I.1.1 Të hyrat nga akciza nga derivatet e naftës për vitin 2023 janë planifikuar të jenë 5.000.000.000 denarë.

I.1.2 Nga kompensimi për shfrytëzimin e rrugës publike, pjesës së saj apo objektit në rrugë (taksë rrugore), parashihen të hyra në vlerë prej 3.800.000.000 denarë. Të hyrat totale mbi këtë bazë llogariten në bazë të frekuencës së arritur të trafikut sipas llojeve dhe kategorive të automjeteve në vitin 2022 dhe të hyrat të realizuara nga vitet e kaluara dhe në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve (taksë rrugore), ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118/19). Këto të hyra janë rritur në krahasim me të hyrat e realizuara në vitin 2022 dhe vitet paraprake, për faktin se në fillim të gjysmës së dytë të vitit 2022, në autostradën Milladinovci - Shtip janë lëshuar në përdorim dy pika pagesore të reja.


I.1.3 Të hyrat e planifikuara nga kompensimin për shfrytëzim të rrugëve publike për automjetet motorike dhe ndihmëse (taksa rrugore) e cila paguhet gjatë regjistrimit të automjeteve, janë 2.300.000.000 denarë. Të hyrat planifikohen dhe realizohen në pajtim me Vendimin për lartësinë dhe mënyrën e pagesës së taksës për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjetet motorike dhe rimorkio (taksa rrugore) ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/09) dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për lartësinë dhe mënyrën e pagesës së taksës për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjetet motorike dhe rimorkio (taksa rrugore) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/14), si dhe në bazë të të hyrave të realizuara nga vitet paraprake sipas kësaj baze.

I.1.4 Të hyrat tjera nga puna në vitin 2023 parashihet të jenë 93.000.000 denarë, dhe janë planifikuar të realizohen nga kompensimi që do të paguhet në rrugët magjistrale dhe rajonale, edhe atë:

- vendosjen e mbishkrimeve dhe tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
- lidhja e rruge hyrëse me rrugë shtetërore,
- vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe mbrojtëse të rrugës shtetërore,
- ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve komerciale në të cilat lejohet qasja në rruge shtetërore jashtë vendbanimit,

- shfrytëzimi i tepruar i rrugës,
- transport i jashtëzakonshëm,
- dëmi i shkaktuar në rrugë dhe objektet rrugore.

➤ Pasqyrë grafike i të hyrave të planifikuara për vitin 2023




I.2 Në vitin 2022 planifikohet të realizohen të ardhura nga kredi të huaja në vlerë të përgjithshme prej 11.508.000.000 denarë, dhe atë

I.2.1 Nga Banka Botërore, për financim të projekteve priten të ardhura prej 1.081.000.000 denarë,

I.2.2 Nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim priten të ardhura prej 4.427.000.000 denarë,

I.2.3 Nga Banka Eksim, për vitin 2023 planifikohet të tërhiqen mjete prej 6.000.000.000 denarë.

- Pasqyrë grafike të të ardhurave të planifikuara nga kreditet e huaja për vitin 2023



I.3 Në Buxhetin e RMV-së për vitin 2023 - Ministria e Transportit - Nënprogrami 2M - Investime në infrastrukturën rrugore - Subvencione kapitale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare janë parashikuar 15.000.000.000 denarë për realizimin e projekteve në përputhje me Ligjin për përcaktimin e interesit publik dhe nominimin e partneritetit strategjik për zbatimin e Projektit për ndërtimin e Korridorit 8 infrastrukturor (segmenti: Tetove - Gostivar – Bukoçjan dhe Projektit të autostradës Trebenishtë – Strugë - Qafë Thanë) dhe Koridori 10d (segmenti i autostradës Prilep - Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

II.

**SHPENZIME TË PLANIFIKUARA, SHLYERJE TË KREDIVE DHE
PROGRAMI INVESTUES I NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË
SHTETËRORE PËR VITIN 2023**

Në vitin 2023 për investime, shlyerje të kredive dhe shpenzimet janë të planifikuara shumë totale prej 38.701.000.000 denarë.


- Pasqyrë tabelare e investimeve të planifikuara, shlyerjeve të kredive dhe shpenzimeve për vitin 2023

SHPENZIME, SHLYERJE TË KREDIVE DHE INVESTIME	38.701.000.000
SHPENZIME	3.082.200.000
1. Shpenzime për materiale për zyrë, materiale shpenzuese, inventar i imët dhe karburant	30.000.000
2. Shërbime për mirëmbajtje të rrugëve, mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve, shërbime komunale dhe shërbime të tjera	1.849.200.000
3. Paga dhe shtesa të tjera për të punësuarit	450.000.000
4. Transferim drejt NJVL-ve për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave	300.000.000
5. Tatimi, kthim të mjeteve nga regjistrimi, provizione bankare dhe shpenzime të tjera nga puna	453.000.000
SHLYERJA E INTERESIT DHE BAZËS SË KREDIVE TË MARRA	5.710.000.000
1. Shlyerja e interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	780.000.000
2. Shlyerja e bazës së kredisë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	4.330.000.000
3. Shlyerje e borxhit të riprogramuar në MF	600.000.000
PROGRAMI INVESTUES	29.908.800.000
1. INVESTIME NGA MJETET VETANAKE	3.400.800.000

1.1 Ndërtim të rrugëve, ndriçimit, sinjalizimit, urave, tuneleve, mbrojtësve ndaj rrëshqitjes së tokës dhe pjesëmarrja vetanake në investime nga kreditet e huaja	1.939.300.000
1.1.1 Ndërtim të rrugëve	873.100.000
1.1.2 Sinjalizim dhe pajisje rrugore	379.500.000
1.1.3 Mbrojtësve ndaj rrëshqitjes së tokës dhe rehabilitim te urave, tuneleve dhe punë të tjera	279.500.000
1.1.4 Pjesëmarrje vetanake në investime me kredi të huaja	407.200.000
1.2. Mirëmbajtje investuese të rrugës	720.000.000
1.3. Shpronësim	200.000.000
1.4. Projektim dhe mbikëqyrje	473.500.000
1.5. Pajisje dhe softuer	68.000.000
2. INVESTIME NGA KREDI TË HUAJA	11.508.000.000
2.1. Kredi nga Banka Botërore	1.081.000.000
2.1.1. Projekt për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve	1.081.000.000
2.2. Kredite nga BERZH-i	4.427.000.000
2.2.1. Sistemi elektronik i pagesës së taksës rrugore Korridorin 10	40.000.000
2.2.2. Projekt për ndërtimin e rrugëve nacionale	2.437.000.000
2.2.3 Projekt për rikonstruim dhe rehabilitimin e segmentit Kriva Pallankë- Deve Bair (kufiri me R. e Bullgarisë)	250.000.000
2.2.4 Projekt për taksë rrugore në Korridorin 8	300.000.000
2.2.5 Bukojçanë-Kërçovë	400.000.000
2.2.6 Shkup- Bllacë	1.000.000.000
2.3. Kredi nga Banka Eksim	6.000.000.000

2.3.1 Projekt për ndërtimin e autostradës Kërçovë- Ohër	6.000.000.000
3. Mjete buxhetore për ndërtimin e segmentit të autostradës: Tetovë - Gostivar - Bukojçan, dhe Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë, dhe Prilep - Manastir,	15.000.000.000

- Pasqyrë tabelare e investimeve të planifikuara, shlyerjeve të kredive dhe shpenzimeve për vitin 2023



II.1. Në vitin 2023 janë planifikuar shpenzime në vlerë totale prej 3.082.200.000 denarë, edhe atë:

II.1.1 Për shpenzime për zyrë, material shpenzues, inventar të imët dhe karburant janë planifikuar gjithsej 30.000.000 denarë. Këto shpenzime kanë të bëjnë me furnizimin e: tonerëve për printera dhe fotokopjues, letra për kasa fiskale në pikat pagesore, bileta paragon, letër për fotokopjim, karburant për agregatet dhe automjete zyrtare, pajisje MHT

për të punësuarit në pikat pagesore, produkte higjienike dhe shpenzime tjera.

II.1.2 Për shërbime të mirëmbajtjes së rrugëve, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjeve, shërbimet komunale dhe shërbimet e tjera, janë planifikuar gjithsej 1.849.200.000 denarë. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë planifikuar për mirëmbajtjen e rrugëve, përmes kontratës me Ndërmarrjen Publike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale. Përveç mirëmbajtjes së rrugëve, ky zë përfshin edhe shërbime për mirëmbajtjen e ndërtesave, objekteve, softuerëve dhe pajisjeve (ashensorë, fotokopjues dhe printera, kondicionerë, automjete, agregate, qendra KZ, aparate KZ dhe testimin e instalimeve të mbrojtjes nga rrufetë, printerët fiskalë, sistemi për video mbykëqyrje dhe pajisje komunikimi të SP dhe pikave kufitare, sistemin e pagesës së taksës rrugore), shërbime komunale, shërbime higjienike, energji elektrike, provizion për shoqatat e kontrollit teknik, avokat, noter, shpenzimet e përmbaruesve dhe shërbime të tjera.


II.1.3 Për paga dhe kompensime të tjera për të punësuarit (të përcaktuara me Ligj, akte nënligjore, kontratat kolektive, akte të ndërmarrjes dhe të ngjashme) janë planifikuar gjithsej 450.000.000 denarë. Këto mjete janë të parashikuara për pagimin e pagës bruto dhe kompensimeve të ndryshme për të punësuarit.

II.1.4 Për transferim në NJVL-të për rikonstruim dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave, janë planifikuar mjete prej 300.000.000 denarë. Mjetet transferohen në përputhje me Ligjin për rrugët publike tek Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale pas dorëzimit të Programit për vitin aktual dhe Raportit të punës për vitin paraprakë.

II.1.5 Për pagimin e tatimeve, kthimin e mjeteve nga regjistrimi, provizionet bankare dhe shpenzimet e tjera operative janë planifikuar

453.000.000 denarë. Në këtë grup bëjnë pjesë: Tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimin e mjeteve nga regjistrimi i automjeteve motorike dhe rimorkiove që kryejnë transport ndërkombëtar të mallrave, provizione bankare, si dhe shpenzime të tjera që dalin nga puna ditore (sigurimi i të punësuarve dhe pronës, transporti i të punësuarve, kontrolli sistematik, transferimi i shpejte i dërgesave, kompensime për anëtarët e BD dhe BM dhe të ngjashme.)

- Pasqyrë grafike për shpenzimet individuale të planifikuara në vitin 2023



II.2 Për shlyerjen e kredive ndaj Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, janë planifikuar mjete në vlerë totale prej 5.710.000.000 denarë, për:

II.2.1. Për shlyerjen e interesit për kredite e marra nga kreditoret e huaj, parashihen mjete në vlerë prej 780.000.000 denarë.

II.2.2. Në bazë të shlyerjes së bazës së kredisë për kredite e marra nga kreditoret e huaj, janë planifikuar mjete në vlerë totale prej 4.330.000.000 denarë.

II.2.3. Për shlyerjen e borxhit te riprogramuar ndaj Ministrisë se Financave janë planifikuar 318.100.000 denarë. Borxhi ndaj Ministrisë

se Financave buron nga shlyerja e anuiteteve ndaj Bankës Eksim, të cilat për Ndërmarrjen Publike i ka kryer Ministria e Financave, dhe me pas janë lidhur marrëveshjet për riprogramimin e borxhit, përkatësisht shlyerjen e të njëjtit në 84 këste mujore.

II.3. PROGRAMI INVESTUES

Ndërmarrja publike në vitin 2023 planifikon të realizojë mjete për investime në vlerë të përgjithshme prej 29.908.800.000 denarë, edhe atë:

II.3.1 Për investime me mjete vetanake dhe buxhetore janë parashikuar 18.400.800.000 denarë.

II.3.1.1 Për ndërtim të rrugëve, rehabilitim, rikonstruimin, ndriçim, sinjalizim, pajisje rrugore, urat, tunelet, mbrojtësve kundër rrëshqitjes së tokës, për pjesëmarrje vetjake në investime të financuara nga kreditorët e huaj dhe punë të tjera janë planifikuar 1,939,000 denarë.

Këto mjete janë të parashikuara për realizimin e projekteve në vijim:

- Projektet e përfunduara, ndërsa do të bëhet pagesa në vitin 2023:
 - Rikonstruim i rrugës rajonale R2133, segmenti Matejç - Likovë,
 - Kompletimi i rrugës rajonale krahu 1 të R-418 (faza 2), në drejtim të fabrikës “Vevçanka” - Shtëpia e shëndetit Vevçani,

- Ndërtimi i rrugës shtetërore R1402 segmenti Konjarevo e Vjetër - Konjarevo e Re,
 - Ndërtimi i urës në rrugën shtetërore R2136 në lumin Pçinjë afër Konjares.
 - Rikonstruimi i rrugës shtetërore R2133 segmenti Ropalcë - Matejçe,
 - dhe projekte të tjera
- Projektet që do të vazhdojnë të realizohen në vitin 2023:
 - Ndërtimi i autostradës A4, pjesa PK “Bllacë” - Shkup (kryqëzimi “Stenkovec”), nënsegmentin 1 - zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PK “Bllacë” deri në f. Bllacë deri në nivelin e autostradës dhe ndërtimi i një pjese të autostradës me një kryqëzim për t'u lidhur me një rrugë lokale për në f. Bllacë,
 - Rehabilitimi i murrit mbrotjes së rrëshqitjes së dheut në R1302, segmenti Hamzali - Berovë
 - Ndërtimi i rrugës rajonale R2246, Izvor (kryqëzimi me A2) – Garski Most,
 - Ndërtimi i autostradës Kërçovë-Ohër,
 - Rikonstruimi i rrugës shtetërore segmenti R1109, qarkorja e Bogdancit
 - Dhe projekte të tjera.
 - Projektet që do të fillojnë në vitin 2023:
 - Ndërtimi dhe zgjerimi me përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugës rajonale R2235, segmenti Nikiforovë – Leunovë – Bunec (kryqëzimi me R1202),
 - Ndërtimi i një ure të re mbi lumin Pçinja për të lidhur autostradën e ardhshme A4, segmenti Milladinovci – Sveti Nikollë – Shtip (kryqëzimi Konjare e Mesme) me rrugën rajonale R2136,

- Rikonstruimi i segmentit Strumicë - Dabile,
- Rehabilitimi dhe përmirësimi i autostradës A1, PK Tabanovcë – Kryqëzimi Tabanovcë
- Rehabilitimi dhe riparimi i rrugës shtetërore R1301, segmenti Ohër - Shën Naumi
- Rikonstruimi me zgjerim të rrugës rajonale R1109 segmenti Ponov most - hyrja në Bogdanci,
- Ndërtimi i qarkores në Tetovë përmes kryqëzimit Trebosh deri në Neproshtenë,
- Përfundimi i ndërtimit të autostradës A4, pjesa PK “Bllacë” – Shkup (kryqëzimi “Stenkovec”), nënsegmenti 1 – zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PK “Bllacë” deri në f. Bllacë deri në nivelin e autostradës dhe ndërtimi i një pjese të autostradës me një kryqëzim për t'u lidhur me një rrugë lokale për në f. Bllacë,
- Përfundimi i punëve të papërfunduara ndërtimore për ndërtimin e autostradës A4, segmenti Milladinovci - Sveti Nikollë - Shtip.
- Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, Qarkorja e Kriva Pallankës
- Përfundimi i kryqëzimit të Bërvenicës
- Riparimi dhe rehabilitimi i rrugëve shtetërore me marrëveshje kornizë
- Ndërtimi dhe zgjerimi me përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugës rajonale R2235 segmenti, Diga e Mavrovës - Kanali i Beliçit,
- Ndërtimi i rrugës drejtimi A1: Prilep - Gradsko, pjesa nga kryqëzimi me rrugën për në fshatin Belovodicë deri te ura për në guroren e Mavrovës.

- Ndërtimi dhe përmirësimi i elementeve gjeometrike të rrugës shtetërore nga kryqëzimi me autostradën A1 - Negotinë,
- Renovimi i mureve mbajtëse te nënkalimi në rrugën shtetërore A2, qarkorja e Shkupit në km. 21+840 deri në km. 21+987
- Riparimi i pjesës në rrugën R1306, segmenti Prilep - Krushevë (te Sllavej)
- Përmirësimi i pjesës së rrugës/ murrir mbrojtjes kundër rrëshqitjes së tokës në rrugë në km 49+800 në R1202, segmenti Kosovrasti - Ura e Melniçkit
- Riparimi i rrëshqitjes në autostradën A3, segmenti Isti Banjë - diga e Kalimancit
- Riparimi i urës mbi lumin Bregallnicë në R1204 në Shtip
- Riparimi i urës mbi lumin Vardar (në afërsi të fshatit Zdunje) në rrugën shtetërore A2, segmenti Gostivar Strazhë.
- Riparimi i urës mbi lumin Shevnica në R1101
- Ndërtimi i urës në R2331, Delnicë Manastir - Nizhe pole
- Riparimi i pjesës në rrugën R1303, segmenti Makedonski Brod - Prilep (Prevoj) Barbaros
- Riparimi i urës nr.15 në hyrje R1303 në Makedonski Brod mbi lumin Treska
- Riparimi i rrëshqitjes/pjerrësisë në R1202, segmenti Ura Boshkov - Ura e Melniçkit (afër Kosovrastit)
- Intervenim pas zbatimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës Themelore Ohër për thellimin e kanalit ekzistues me tuba në pjesën e rrugës magjistrale A2, segmenti Podmolje - Strugë.
- Riparim (lyerja) e tuneleve në autostradën A1, segmenti Demir Kapi - Smokvicë.
- Marrëveshja kornizë për riparimin e mbrojtësve kundër rrëshqitjeve të tokës dhe rrëshqitjeve në rrugët shtetërore

- Vendorsja e sinjalizimit dhe pajisjeve të komunikacionit në rrugën shtetërore A3, segmenti Bukovë - Ohër, nënsegmenti Bukovë - hyrja në Ohër.
 - Vendorsja e sinjalizimit dhe pajisjeve të komunikacionit për të rritur sigurinë në komunikacion
 - Vendorsja e sinjalizimit të komunikacionit në rrugën shtetërore R1206, segmenti Zhelinë - Tetovë dhe segmentin Saraj - Karpalak.
 - Vendorsja e sinjalizimit të komunikacionit për drejtimin e trafikut në rrugët shtetërore në përputhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve
 - Vendorsja e gardhit mbrojtës me zë në pjesë të caktuara të autostradës përgjatë korridoreve 8 dhe 10 (pranë qytetit të Kumanovës, pranë vendbanimit Saraj)
 - Vendorsja e sinjalizimit të komunikacionit në rrugën shtetërore R1203 segmenti Tetovë - PK Jazhincë
 - Furnizimi i profilometrit
 - Furnizimi i deflektometrit
 - Furnizimi i PAVEMENT FRICTION TESTER (PFT)
 - dhe projekte të tjera.
- Nëse sigurohen mjete në vitin 2023, planifikohet të fillojnë projektet në vijim:
 - Ndërtimi rrugës së shpejt segmenti Manastir - Mejitlia qarkore në Manastir,
 - Ndërtimi i rrugës shtetërore Strumicë - Valandovë - kryqëzimi me A1,
 - Ndërtimi i rrugës shtetërore A3 qarkore në Resnjë,
 - Rehabilitimi i autostradës Hipodrom - Milladinovci (të dyja korsitë),

- Rehabilitimi i autostradës Petrovec - Milladinovci (të dyja korsitë),
- Rehabilitimi i autostradë Hipodromit - Petrovec (të dyja korsitë),
- Rehabilitimi i rrugës rajonale Krivogashtani - Krushevë,
- Rehabilitimi i rrugës rajonale Lopaticë - Sladuevë (Demir Hisar),
- Rehabilitimi i rrugës rajonale Krushevë - Sladuevë (Demir Hisar),
- Rehabilitimi i rrugës rajonale Slladuevë (Demir Hisar) - Drugovë (Kërçovë)
- dhe projekte të tjera.

II.3.1.2 Për mirëmbajtjen investuese të rrugëve parashihen 720.000.000 denarë. Pjesa më e madhe këtyre mjeteve do të realizohen përmes kontratës me Ndërmarrjen Publike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të parashikuara ne Programin Vjetor për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2023;

II.3.1.3 Për shpronësim të tokës, ndërtesave, pyjeve, plantacioneve dhe të mbjellave të segmentit që planifikohen për ndërtim gjatë vitit 2023, janë planifikuar 200.000.000 denarë;

II.3.1.4 Për përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe mbikëqyrjen e punëve ndërtimore në rrugët shtetërore, parashikohen mjete në vlerë prej 473.500.000 denarë. Ky pozicion përfshinë shpenzime për përgatitjen e studimeve fizibiliteti, projekteve të infrastrukturës, studimeve të mjedisit jetësor, projekteve themelore dhe pjesëve të tjera të dokumentacionit

tekniko-investues, siç është mbikëqyrja mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.

Në vitin 2023 planifikohet pagesa sipas kontratave tashmë të lidhura për përgatitjen e dokumentacionit të projektit për segmentet në vijim:

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për segmentin e autostradës Manastir - Mejitlia me qarkoren në Manastir,
- Përgatitja e projektit bazë për rrugën shtetërore A2 segmenti Bukojçan – Kërçovë,
- Përgatitja e projektit infrastrukturor për rrugën shtetërore A2 segmenti Bukojçan – Kërçovë,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për segmentin Strumicë - Valandovë - kryqëzimi me A1,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e mureve rezistuese në rrugën R1202, në afërsi të fshatit Jançe dhe fshatit Skudrinje.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugës shtetërore A3 qarkorja Resnje,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për vendosjen e sinjalizimit dhe pajisjeve të komunikacionit në rrugën shtetërore A3, segmenti Bukovë - Ohër,
- Përgatitja dhe kompletimi i dokumentacionit të projektit për lidhjen e autostradës së ardhshme A4 segmenti Milladinovci – Sveti Nikollë – Shtip (kryqëzimi Konjare e Mesme) me rrugën rajonale R2136,
- Përfundimi i dokumentacionit ekzistues të projektit dhe përgatitja e një projekti infrastrukturor për rikonstruim me zgjerimin e rrugës rajonale R2236 segmenti Sveti Nikollë - Neokazi,

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për riparimin e rrëshqitjes në R1306, segmenti Krushevë - Slladuevë,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e qarkores të Tetovës përmes kryqëzimit Trebosh në Neproshtenë,
- Ndryshimi dhe plotësimi i projektit të infrastrukturës për ndërtimin e rrugës rajonale R2138, lidhje me rrugën rajonale R2134, me vendbanimin Sonçev Grad,
- Plotësimi i dokumentacionit të projektit për ndërtim dhe zgjerim me përmirësim të elementeve gjeometrike të rrugës rajonale R2235 segmenti Nikiforovë – Leunovë – Bunec (kryqëzimi me R1202)
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrugës shtetërore A2, qarkorja e Kriva Pallankës,

Në vitin 2023, është planifikuar të përgatitet dokumentacioni i projektit për segmentet e reja:

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin dhe riparimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Demir Kapi - Negotinë (të dyja korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për mbrojtjen e shpateve për autostradën A4, segmenti Milladinovci – Sveti Nikollë – Shtip,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për përfundimin e qarkores të Bogdancit, që është pjesë e rrugës shtetërore R1109,
- Përgatitja e projektit bazë dhe urbanistik për ndërtimin për lidhjen e Tetovës me Prizrenin (Kosovë)

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për zgjerimin dhe përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugës shtetërore R2234, segmenti Kondovë - Radushë - Jegunovcë,
 - Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrugës shtetërore A1, segmenti kryqëzimi Gjevgjeli - KP Bogorodica (korsia e djathtë),
 - Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën e shpejtë, segmenti Strumicë - kufiri me R. e Bullgarisë,
 - Përgatitja e dokumentacionit të projektit për zgjerimin e rrugës shtetërore A3 në lidhjen nga dy korsit në një, nga Dellçeva në fshatin Zvegor, për përmirësimin e sigurisë në komunikacion.
 - Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e urës në lumin Vardar afër fshatit Bashino, e cila është pjesë e rrugës rajonale R1312,
 - Rikompletimi i dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës rajonale R1106 segmenti Nova Breznicë - Kula - Kolomot,
 - Rikompletimi i dokumentacionit të projektit për ndërtim dhe zgjerim me përmirësim të elementeve gjeometrike të rrugës rajonale R2235 segmenti, Diga Mavrovë - kanali Beliçki,
 - Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës shtetërore segmenti R1202, qarkorja në Dibër, (njëkohësisht të kryhet procedura për kategorizimin nga rruga lokale në atë shtetërore),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës shtetërore sStrugë- Belica e Epërme, Vevçani, (njëkohësisht të kryhet procedura për kategorizimin nga rruga lokale në atë shtetërore),

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës shtetërore Strezimir - Lukovopol - Kufiri me Republikën e Kosovës (njëkohësisht të kryhet procedura për kategorizimin nga rruga lokale në atë shtetërore),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës shtetërore Drenovë – Jabollçishtë e Epërme – Nezhillovë – kryqëzimi me rrugën rajonale R2336 (njëkohësisht të kryet procedura për kategorizimin nga rruga lokale në atë shtetërore),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për mbrojtjen e shpateve të rrugës shtetërore R1202, pjesa Mavrovi Anovi - Zhirovnice,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtim dhe zgjerim me përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugës rajonale R2335, Ropotovë – Lazhan – Zhitoshë,
- Rikompletimi i dokumentacionit të projektit për ndërtimin e autostradës A4, segmenti PK “Bllacë” – Shkup (kryqëzimi “Stenkovec”), nënsegmenti 1 – zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PK “Bllacë” deri në f. Bllacë deri në nivelin e autostradës dhe ndërtimi i një pjese të autostradës me një kryqëzim për t'u lidhur me një rrugë lokale për në f. Bllacë, lidhje me rrugë lokale për në fshatin Bllacë,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin dhe riparimin e rrugës shtetërore A2, segmenti Shkup - Tetovë (të dyja korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin dhe riparimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Negotinë - Stobi (të dyja korsitë),

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin dhe riparimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Stobi - Gradsko (të dyja korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin dhe riparimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Gradsko - Veles (të dyja korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin dhe riparimin e rrugës rajonale R1310 segmenti Berovë - PK Klepalo,
- Rikompletimi i dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës rajonale R1107 segmentii Rozhden - Majden - PK Pulevec,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për përfundimin e kryqëzimit të Bërvenicës,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për plotësimin e projektit bazë dhe projektit të infrastrukturës për ndryshim dhe plotësim të projektit të infrastrukturës për ndërtimin e rrugës shtetërore R2246, segmenti Ura e Garskit - Ehlovec (Burimi)
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrëshqitjes së dheut në rrugën magjistrale A4, segmenti kryqëzimi Stenkovec - PK Bllacë.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrëshqitjes së dheut në rrugën magjistrale A3, segmenti Isti Banjë - diga e Kalimancit (mbi fshatin Istibanjë)
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rehabilitimin e rrëshqitjes/pjesës së rrugës në km 49+800 në R1202, segmenti Kosovrasti - Ura e Melniqkit
- Përgatitja e dokumentacionit teknik për zbatimin e vendimit gjyqësor të gjykatës themelore Ohër për thellimin e kanalit

ekzistues me tuba në pjesën e rrugës magjistrale A2, segmenti Podmolje - Strugë.

- Përgatitja e dokumentacionit teknik - Projekti i komunikacionit në rrugën shtetërore R1309: Zrnovce-Cocani-Ponikva
- Përgatitja e dokumentacionit teknik Projekti i komunikacionit në rrugën shtetërore R1203 pjesa Tetovë-PK Jazhincë

Përgatitja e dokumentacionit të projektit për sinjalizimin e

komunikacionit për drejtimin e komunikacionit në rrugët shtetërore në përputhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për riparimin e urës R2250, segmenti Kiselicë - Lukë.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për riparimin e urës mbi lumin Bregalnica në R1204 në Shtip
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për riparimin e një ure në rrugën shtetërore A2 afër Tasina Çeshmës në km 149+050
- Përgatitja e dokumentacionit teknik - Projekti i komunikacionit në rrugën shtetërore R1310: Radovish-Podares dhe R29471 segmenti: Podaresh-Pokrajçevë
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për riparimin e mureve rezistuese në nënkalimin e rrugës shtetërore A2, Qarkorja e Shkupit në km 21+840 deri në km 21+987.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për riparimin e urës afër Zhirovnicës në km 30+626
- Përgatitja e dokumentacionit teknik - Projekti i komunikacionit në rrugën shtetërore R2334: Shtip - Karbinci - Argulicë

- Përgatitja e dokumentacionit teknik - Projekti i komunikacionit në rrugën shtetërore R1309: Zletovë - Dobrevë - Probishtip dhe rruga shtetërore R2232 segmenti: lidhja R1309/2232 Ratavicë – Zletovë
- Përgatitja e dokumentacionit teknik - Projekti i komunikacionit në rrugën shtetërore R2242 Zhelino - Jegunovc lidhja me R2234 dhe rruga rajonale R2234 Jegunovc - Tearcë
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës shtetërore qarkorja Novaci, (njëkohësisht të kryhet procedura për kategorizimin nga rruga lokale në atë shtetërore),
- dhe projekte të tjera

Nëse sigurohen mjete në vitin 2023, planifikohet të fillohen projektet në vijim:

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për kryqëzimin e rrugës së shpejt A2, segmenti Kriva Pallankë – kryqëzimi me rrugën magjistrale ekzistuese,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës së shpejtë në rrugën shtetërore A3 segmenti Koçan - Dellçevë.
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e rrugës së shpejtë në rrugën shtetërore A3 segmenti Trebenishtë - Kosell.
- dhe projekte të tjera

II.3.1.5 Për furnizim të pajisjeve dhe softuerëve janë planifikuar 68.000.000 denarë.

II.3.2 Për investime nga kreditë e huaja, 11.508.000.000 denarë janë planifikuar dhe financuar nga: Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Eksim Banka.

II.3.2.1 Kredi nga Banka Botërore në vlerë prej 1,081,000,000 denarë, për projektet në vijim:

- Me projektin për përmirësimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuar nga Banka Botërore, do të financohen:
 - Ndërtimi i rrugës së shpejt Rankovcë – Kriva Pallankë,
 - Shërbimet e konsulencës: Asistencë e NPRRSH për aktivitetet përgatitore për futjen e një sistemi të menaxhimit me urat,
 - Shërbimet e konsulencës: Hulumtimi ex-ante dhe ex-post i përdoruesit dhe vlerësimi i ndikimit
 - Auditimi teknik gjatë ndërtimit të rrugës së shpejt Rankovcë – Kriva Pallankë,
 - Eksperti i furnizimeve,
 - Hardueri dhe softueri i Sistemit të menaxhimit me ura (BMS),
 - Shërbime konsulence për kontrollimin e gjendjes së urave,
 - Shërbime konsulence – furnizim dhe instalim i një moduli analitik për urat BMS,
 - Dhe projekte të tjera

II.3.2.2 Kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 4,427,000,000 denarë, për projektet në vijim:

- Projekti Korridor 10 – taska rrugore, për futjen e një sistemi elektronik për pagesën e taksës rrugore në Korridorin 10 dhe

ndërtimin e pikave të reja pagesore në segmentin e autostradës së saponëdërtuar.

- Me Programin e Projektit për Rrugët Kombëtare do të financohen:
 - Ndërtimi i rrugës së shpejtë Shtip – Koçan (segmenti Shtip – Krupisht ka përfunduar dhe segmenti Krupisht – Koçan),
 - Ndërtimi i rrugës së shpejtë Gradsko - Prilep, segmenti (Farish - Drenovë),
 - Rehabilitimi i disa rrugëve shtetërore: Katllanovë – Petrovec (2 korsi), Mavrovi Anovi – Zhirovnicë, Farishka Klisura – Prilep, .
 - Rehabilitimi i 5 rrugëve: Shkup - Bllacë, Podmolje - Strugë - Qafë Thanë, Manastir - Medzhitlia, Katllanovë - Veles dhe Veles - Gradsko.
 - Ndhimë teknike për Njësinë e implementimit të projektit,
 - Dhe projekte të tjera
- Me Projektin Kriva Pallankë - Deve Bair, me grante të siguruar nga Bashkimi Evropian dhe kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, financohet rindërtimi dhe rehabilitimi i rrugës Kriva Pallankë - Deve Bair.
 - Asistencë teknike
- Projekti i taksave rrugore të autostradës, financohet për futjen e një sistemi elektronik të pagesës së taskës rrugore në Korridorin 8 dhe ndërtimin e pikave të reja pagesore në segmentet e autostradës të saponëdërtuara.
 - Shërbimet konsulente për mbështetjen e projektit për ndërtimin dhe instalimin e pikave pagesore në Korridorin 8 dhe autostradën Milladinoci-Shtip (faza 2)


- Ndërtimi i autostradës Bukojçan-Kërçovë, financohet me grante nga Bashkimi Evropian dhe kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
- Përgatitja e projektit bazë për ndërtimin e autostradës, Bukojçan - Kërçovë,
- Mbikëqyrja e ndërtimit të autostradës, Bukojçan - Kërçovë,
- Asistencë teknike
- Dhe projekte të tjera
- Ndërtimi i autostradës Shkup - Bllacë, financohet me grante të siguruar nga Bashkimi Evropian dhe kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
- Mbikëqyrja e ndërtimit të autostradës, Shkup - Bllacë,
- Asistencë teknike
- Dhe projekte të tjera

II.3.2.4 Kredi nga Eksim Banka në vlerë 6.000.000.000 denarë, për financim të:

- Ndërtimit të autostradës Kërçovë - Ohër

III. Për realizimin e Projektit për ndërtimin e Korridorit 8 infrastrukturor (segmenti: Tetovë – Gostivar – Bukojçan dhe Projekti për autostradën Trebenishtë – Strugë – Qafë Thanë) dhe Korridorit 10d (segmenti i autostradës Prilep – Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, janë parashikuar 15.000.000.000 denarë në Buxhetin e RMV për vitin 2023 - Ministria e Transportit - Investimet në infrastrukturën rrugore - Subvencione kapitale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare.

➤ Pasqyrë tabelara e investimet e planifikuara në vitin 2023



III.

Ky Program hyn në fuqi me ditën e miratimit të tij, ndërsa do të fillon të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

BORDI DREJTUES I NP PËR RRUGË

SHTETËRORE

KRYETARE

LJUPKA CIKARSKA

